



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 85 prot.

Kamëz, më 14.06.2024

V E N D I M
Nr. 65.Datë 14.06 2024
M B I

“DHËNIE NDIHME EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË NGA
BUXHETI I BASHKISË”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 14.06.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.45 Datë 10.06.2024 në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, ligji nr.57 dt. 18/07/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV, të Vendimit nr. 597 datë. 04/09/2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKB nr.103 dt 18.12.2023 “ Mbi detajimin e buxhetit për vitin 2024, 2025, 2026; VKB nr. 6 datë 22.01.2024 mbi miratimin e kriterëve për trajtimin me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë për vitin, 2024”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e përdorimit të të ardhurave të bashkisë për ndihmë ekonomike me një fond prej **200.000 (dyqindmijë)** lekë për muajin **Qershor 2024**. Fondi do të përballohet sipas strukturës buxhetore Gr 0, prog., 10430, Kap.5, Art 606.
2. Miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike për familjet si më poshtë.
 - a) me vlerën 100,000 lekë si një rast i veçantë për gjendjen shëndetësore.
 - b) me vlerën 100,000 lekë si një rast i veçantë për gjendjen shëndetësore të saj.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë**.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

